



Gjetja e të vërtetës në epokën e lajmeve të rreme: Kompetenca në informacion në dritën e Islamit

Description

Justin Parrot

Hyrje

Karakteristika më përkufizuese e epokës sonë është mbizotërimi i të gjitha llojeve dhe burimeve të informacionit. Kompjuterët, telefonat *smart*, mediat sociale, dhe, sigurisht, interneti në përgjithësi, mund të na ofrojnë gjëra që ne duam të dimë, kur ne duam t'i dimë ato, dhe kjo në mënyrë të menjëhershme. Pa dyshim, këto mjete kanë potencialin që të ofrojnë një avantazh të jashtëzakonshëm për studiuesit, hulumtuesit, dhe ata që njihen si nxënës apo kërkues të diturisë.

Por dobietë e këtyre teknologjive kompensohen nga ana e tyre e errët: keqinformimi, dezinformimi, dhe shndërrimi në armë i teknologjisë së informacionit. Si çdo mjet, teknologjitë e informacionit mund të shfrytëzohen, dhe ato madje shfrytëzohen, për qëllime të liga. Ato përhapin gënjeshtër në botë sa hap e mbyll sytë, ndezin panik ose tërbimin e turmave me mesazhe të rreme, dhe madje edhe ndryshojnë për keq kursin e kombeve të tëra. Disa profesionistë kanë emërtuar situatën aktuale me termin ogurzi epoka e “post të vërtetës”.^[1]

Për këtë arsye, një kompetencë kyçe në epokën tonë të informacionit është aftësia për të shoshitur malet e informacioneve për të bërë dallimin ndërmjet të mirës, të keqes, dhe të shëmtuarës. Kjo është ajo çka shkencëtarët dhe profesionistët e informacionit e cilësojnë si *kompetenca në informacion* (information literacy).

Si myslimanë, verifikimi i të vërtetës, metodologjia e burimeve, dhe vetë menaxhimi i dijes janë komponentë thelbësorë të fesë sonë, gjë që është arsyeja përse dijetarët, për shembull, kanë bërë një punë të stërmadhe për të saktësuar atë që ka thënë në të vërtetë Profeti Muhamed (a.s.)! Imam Muslimi (rahmet pastë) si parathënie të përmbledhjes së tij të haditheve autentike ka parashtruar një

kapitull të titulluar “Zinxhiri i verifikimit (*sened*) është pjesë e fesë dhe transmetimet pranohen vetëm nga ata që janë të besueshëm.”^[2] Duke sendërtuar mbi këtë precedent, ne mund të ndërthurim leksionet e pararendësve tanë të drejtë me parimet moderne të kompetencës në informacion (information literacy) për të na ndihmuar që të lundrojmë në dallgët e këtij oqeani masiv të informacioneve.

Ky artikull përkufizon kompetencën në informacion dhe i ndërlidh parimet dhe metodat e saj me precedentët në trashëgiminë dhe traditën tonë islame.

Çfarë është kompetenca në informacion?

Sipas Shoqatës Amerikane të Biblotekave (American Library Association ALA), kompetenca në informacion përkufizohet si “seti i aftësive të integruara që përfshijnë zbulimin reflektiv të informacioneve, të kuptuarit se si informacioni prodhohet dhe vlerësohet, dhe përdorimin e informacionit në të krijuarit e dijes së re dhe në të marrurit pjesë në mënyrë etike në komunitetet e nxënies.”^[3] Këto aftësi përfshijnë zotësitë akademike dhe teknologjike, si edhe të menduarit kritik, logjikën, dhe tendencat e qëndrimit. Kompetenca e informacionit është thjesht “të mësosh si duhet mësuar” në epokën e informacionit. Tiparet kyçe të epokës aktuale janë se “ndryshimi do të jetë konstant, dhe se ky ka për të qenë një shekull me një sasi të pamasë të dhënash dhe informacionesh.”^[4]

Së pari, ne duhet të bëjmë dallimin ndërmjet “diturisë” dhe “informacionit”. Rreth tridhjet vjet më parë, studiuesi futurist John Naisbitt ankohej se “Ne po mbytemi me informacion, por po vuajmë nga mungesa e diturisë”.^[5] Kjo ishte gjendja e punëve përpara ardhjes së internetit, *smartphone*-ve, dhe mediave sociale, kështu që thënia e tij është edhe më e vërtetë sot.

Dija e vërtetë është të kuptohet diçka sikundërse ajo faktikisht ekziston në realitet, bazuar mbi premisën se ekziston ajo që quhet realitet objektiv. Në kontrast, informacioni përbëhet nga raportimet dhe të dhënat, që mund të jenë të vërteta por janë të prirura ndaj keqinterpretimit, keqparaqitjes, dhe falsifikimit të hapur. Kur informacioni është i rremë apo çorientues, ai quhet keqinformim. Kur informacioni falsifikohet qëllimisht për të mbuluar me tis të vërtetën, ai quhet dezinformim; kurse në formën siç aplikohet ndaj shteteve dhe ushtrive, ai quhet *luftë e informimit*.

Al-Mahali, teksa komenton mbi tekstin klasik të Imam Xhujnit (rahmet pastë) mbi themelet e jurisprudencës islame (usul fik’hun), e përkufizon dijen dhe injorancën si më poshtë:

Dija është të njohësh atë që është e ditur, domethënë, konceptimin e diçkaje që dikush e di, sikundërse ajo ekziston në realitet.... Injoranca është të përfytyrosh diçka, domethënë, ta sendërgjosh atë, ndryshe nga ç’është në realitet.^[6]

Kësodore, ka të ngjarë që një person të ketë akses në të gjitha llojet e keqinformimit dhe dezinformimit, duke krijuar kështu iluzionin e dijes, por që, në fakt, është injorancë e plotë. Kur disa pohime të rreme në mendjen e një njeriu përforcojnë njëra tjetrën, kjo rezulton në injorancë të përbërë (*xhehl murekkeb*), për të cilën mund të gjendet shërim vetëm nëpërmjet një procesi të gjatë të demaskimit të çdo informacioni një e nga një.

Vetëm dija autentike e realitetit, jo thjesht informacioni, është ajo që i jep njerëzve një epërsi në raport me të tjerët, sikundërse ka thënë Allahu: “Si mund të jenë të barabartë ata që nuk dinë me ata që

dinë? Vetëm ata që kanë kuptim kanë për t'u treguar të vëmendshëm.”[\[7\]](#) Kësodore, është detyra jonë që ta kërkojmë të vërtetën dhe ta pranojmë atë kurdoherë dhe kudo që ne e gjejmë atë.

Kudogjendshmëria e informacioneve të rreme, dhe lehtësia me anë të së cilës ato transmetohen, është një kërcënim i qartë dhe aktual ndaj shoqërive dhe komuniteteve. Sipas Anne P. Mintz:

Keqinformimi në internet është i rrezikshëm dhe është pjesë e një tabloje shumë më të gjerë. Shtrembërimi i të vërtetës apo thënia e gënjeshtreve haptazi nuk është një risi. Thjesht ka ndryshuar lajmëtari, dhe ky lajmëtar e përhap fjalën me shpejtësi rrufe dhe deri në vende të largëta. Vetëm gjatë dekadës së fundit, ne kemi parë me sytë tanë se si qeveritarë dhe drejtorë korporatash kanë keqinformuar publikun në mënyra që kanë patur pasoja vigane, disa madje kanë përfshirë dhe jetën e vdekjen, dhe të tjera akoma kanë kontribuar në rrënie financiare.[\[8\]](#)

Alan Bundy, studiues i informatikës, pohon se kompetenca e informacionit është kompetenca kyçe e shekullit XXI. Pa një masë kritike qytetarësh që janë kompetentë në shohitjen e një shkapërderdhjeje të informacioneve – shohitja e informacionit të mirë nga informacioni i keq – shoqëria rrezikon që të dështojë së prodhuari dije të re të mjaftueshme, nga e cila mvaret ekonomia globale, si edhe do të dështojë së adresuari sfidat reciproke mbarëbotërore që kërcënojnë planetin dhe vetë civilizimin njerëzor.[\[9\]](#) Pikërisht sikundër shoqëria njerëzore në të kaluarën i kërkonte qytetarëve të saj që të mësonin shkrim e këndim për mbijetesë, sot ne kemi një nevojë të dëshpëruar që qytetarët të bëhen kompetentë në aksesin, vlerësimin, dhe teknologjinë e informacionit.

Kompetenca e informacionit ka gjithashtu një peshë të veçantë për bashkësinë tonë, për shkak se armiqësia anti-myslimane që ne e quajmë Islamofobi bazohet gjerësisht mbi keqinformimin, dhe ndonjëherë mbi dezinformimin, në internet në lidhje me fenë tonë dhe mësimet e saj.

Madje ka dhe raste kur disa myslimanë e kanë lënë Islamin për shkak se atyre u janë prezantuar keqinterpretime të teksteve të shenjta, keqinterpretime që, fatkeqësisht, ndonjëherë përforcohen nga myslimanë që nuk dinë aq sa duhet.

Ne duhet të shqetësohemi, por gjithashtu duhet të jemi edhe optimistë. Zotësitë që ne lipset të përftojmë nuk janë tmerrësisht të vështira për t'u kuptuar apo mësuar, dhe ato kanë precedentë të fortë në traditën tonë islame. Ne thjesht po sendërtojmë mbi metodat ditunore të paraardhësve tanë për t'iu përgjigjur nevojave të një epoke të re.

Një jetë kushtuar diturisë

Pjesa më e rëndësishme e të përftuarit të kompetencës në informacion mund të jenë tendencat qëndrimore që duhet të qëndrojnë në themel të saj. Me fjalë të tjera, ne lipset që të zhvillojmë karakter të mirë, kureshtje intelektuale, dhe përlësi, pasi të gjitha këto lehtësojnë maturimin personal që nevojitet për t'u marrë me një gamë të gjerë të informacioneve.

Sikundërse ne e dimë (apo sikundërse *duhet* ta dimë), kategori të caktuara të dijes janë të detyrueshme për myslimanët, siç janë bazat e kredos islame, apo akideja, adhurimi, dhe etika. Megjithatë, ky është vetëm detyrimi minimal, siç është ravijëzuar kjo nga dijetarët. Ata nga gjiri ynë të cilët duan të çojnë më tutje të kuptuarin fetar, apo të çojnë përpara kontributin tonë ndaj bashkësiveve nëpërmjet lëmvive dobiprurëse të shkencës dhe administrimit, duhet të kultivojnë një etje për dijedhe një *identitet* si nxënës përgjatë gjithë jetës.

Allahu, ç'është e vërteta, e ka urdhëruar Pejgamberin (a.s.) dhe kësodore të gjithë ne, që t'i lutemi atij që të na shtojë dijen, sikundër ka thënë Ai: "Thuaj: O Zot, ma shto dijen!"^[10] Rrjedhimisht, Pejgamberi (a.s.) e ka konsideruar nxënien e parreshtur si një obligim për myslimanët: "Kërkimi i dijes është një detyrë për çdo mysliman."^[11] Vetë Pejgamberi (a.s.) e ka zbatuar këtë këshillë dhe ai nuk reshti së mësuari deri në ditën që ndërroi jetë. Ibn Utejbëh (rahmet pastë) ka thënë: "Pejgamberi (a.s.) vijoi që të shtonte dijen derisa Allahu Fuqiptotë ia mori shpirtin."^[12]

Ka vetëm dy lloje të urisë së parreshtur që nuk mund të shuhen kurrë, siç ka thënë Pejgamberi (a.s.): "Kërkimtarët e dy shqetësimeve nuk janë kurrë të kënaqur: kërkimtari i dijes dhe kërkimtari i dynjasë."^[13] Dhe Pejgamberi (a.s.) po ashtu ka thënë: "Musai e pyeti Zotin e tij: Cilët janë robërit e Tu më të ditur? Allahu tha: Një dijetar që nuk mjaftohet me dijen që ka, dhe dijen që kanë njerëzit e tjerë ia shton dijes së tij."^[14] Duke qenë se është kështu, ne duhet t'i drejtojmë përpjekjet tona më të mira kah dija dobiprurëse dhe jo nga kënaqësitë kalimtare të kësaj bote.

Imamët, dijetarët, dhe udhëheqësit e mëdhenj të fesë sonë e kanë parë veten si nxënës përgjatë gjithë jetës. Imam Maliku (rahmet pastë) ka thënë: "Nuk i ka hije një të dituri që të heqë dorë nga të mësuari."^[15] I thanë Ibn el-Mubarekut (rahmet pastë): "Edhe për sa kohë do të kërkosh dijen?" Ai u përgjigj: "Deri në vdekje, inshaAllah. Ndoshta fjalët që do të më bëjnë dobi mua ende nuk janë shkruar."^[16] Ibn el-Mubareku, në një rast tjetër, ka thënë: "Një person do të vazhdojë që të ketë dije për sa kohë që ai kërkon dije. Në qoftë se ai e merr si të mirëqenë se është i ditur, atëherë ai është bërë i paditur."^[17] Dhe Ibn Ebi Ghassani (rahmet pastë) ka thënë: "Do të kesh dije për sa kohë që je student. Në qoftë se e konsideron veten të mjaftueshëm, atëherë bëhesh injorant."^[18] E thënë ndryshe, ti do të vazhdosh që të kesh dije për sa kohë që vijon të kërkosh dituri me metodat e duhura; kur ti resht së nxëni, ti bëhesh injorant. Njëlloj si peshkaqenët, nëse nuk jemi duke notuar, biem në fund të detit.

Pejgamberi (a.s.), krahas kërkimit për dituri fetare, na nxiti që të kërkojmë edhe dituri dobiprurëse nga shkencat natyrore, zanati i tregtisë, mjekësia, dhe shumëçka tjetër. Një episod i veçantë shpërfaq një kufi ndërmjet diturisë fetare dhe diturisë së kësaj dynjaje. Pejgamberi (a.s.) kaloi njëherë pranë disa njerëzve që po shartonin pemë dhe u tha: "Më mirë të mos veproni ashtu!" Ata hoqën dorë nga ajo mënyrë e shartimit, por pati një rënie në të vjelurat. Ai kaloi sërish andejpari dhe u tha atyre: "Çfarë paska ndodhur me pemët tuaja?" Ata i thanë: "Ju na thatë të mos vepronim ashtu." Pejgamberi (a.s.) u tha: "[Por] Ju i dini më mirë punët e botës suaj."^[19] Në një tjetër transmetim të kësaj ndodhie, Pejgamberi (a.s.) tha: "Në të vërtetë, unë jam vetëm një qenie njerëzore. Në qoftë se unë ju urdhëroj që të veproni diçka në fe, atëherë veproni sipas saj. Në qoftë se unë ju urdhëroj që të veproni diçka nga gjykimi im, atëherë [dijeni se] unë jam thjesht njeri."^[20]

Bashkësia myslimane ka një nevojë kolektive si për dije fetare ashtu dhe për dije të kësaj bote. Imam Shafiu (rahmet pastë) ka thënë: "Në të vërtetë, dija ndahet në dy lloje: dije për fenë dhe dije për dynjanë. Dijsa për fenë nënkupton që të arrihet të kuptuarit për ligjin (fik'hun) kurse për dynjanë është mjekësia. Mos u shpërngulni në një tokë ku nuk ka një dijetar që t'ju vërë në dijeni për fenë tuaj, dhe ku

nuk ka asnjë doktor që t'ju informojë për trupin tuaj.”^[21] Pra, në kohën e Shafiut, mjekësia ishte shkenca më e rëndësishme e kësaj bote dhe ai e cilësonte atë të *domosdoshme* që një ekspert mjekësor të jetonte në çdo qytet mysliman. Në kohët tona, janë zhvilluar kategori të tjera të diturisë, të cilat janë esenciale për jetën moderne.

Si kërkimtar i dijes, *ti* duhet të gjesh rolin tënd në bashkësi, qoftë si dijetar feje, shkencëtar, administrator, doktor, tregtar, apo çdo profesion tjetër, dhe më pas ta drejtosh nxënien tënde drejt arritjes së kompetencës, dhe eventualisht ekspertizës në lëminë që ke zgjedhur.

Mbasi thamë këtë, duhet të jesh i vetëdijshëm se dija ndahet ndërmjet asaj që është dobiprurëse dhe asaj që është e kotë apo madje edhe e dëmshme. Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Lutjuni Allahut për dije dobiprurëse dhe kërkoni mbrojtje tek Allahu nga dija e pavlerë.”^[22] Cilido qoftë roli që ne të vendosim të marrim dhe për të cilin ne angazhohemi për të mësuar gjatë gjithë jetës, ai në njëfarë mënyre duhet të jetë i dobishëm për bashkësinë. Imam Gazaliu, për shembull, i përshkruan disa lëmi të dijes, apo “shkenca”, si “të dënueshme”, siç janë astrologjia, leximi i fallit, dhe shkencat okulte.^[23] Është e palejueshme në Islam që të studiohen subjekte të tilla me qëllimin për t'i praktikuar ato. Kështu që, pavarësisht se për cilën fushë të diturisë angazhohesh, ti duhet të jesh i sigurtë se ajo do të jetë dobiprurëse si për ty ashtu dhe për bashkësinë tënde.

Si njerëz që ia kushtojmë jetën nxënies së dijes, ka shumë rëndësi që ne të kemi *përrulësi intelektuale*. Duhet pranuar mundësia që në çështje fetare të dorës së dytë, si edhe në çdo orvatje të kësaj dynjaje, mund ta kesh gabim ose mund të jesh gabuar. Ibn Haxher el-Hejtemiu, kur e pyetën në lidhje me mospajtimet në çështjet fetare të dorës së dytë (*el-furu'*), ka thënë: “Medhhebi ynë është i saktë, por mund ta ketë patur gabim [në një gjykim]. Medhhebi i atyre që nuk pajtohen me ne është i gabuar, por mund të jetë i saktë [në aksh gjykim].”^[24] I njëjti qëndrim jetësohet në çdo lëmi të diturisë, ne ndjekim informacionin më të përpiktë që arrijmë të gjejmë, ndërkohë që mbajmë parasysh se, si çdokush tjetër, ne kemi njëanshmëritë tona dhe ne kryejmë gabime. Vlerësimi i herëpashershëm i vetes dhe kujdesi i brendshëm (vetë-refleksiviteti sh.p.) është i domosdoshëm për të shmangur stanjacionin intelektual. Në qoftë se ne dështojmë që të pranojmë se perspektiva jonë ka një masë të subjektivitetit, ne mund të keqduhëzohemi nga vetë *prirja jonë për konfirmim*, që është tendenca jonë për të pranuar pa asnjë lloj kritike informacione të tjera që mbështesin narrativën apo teorinë tonë para-ekzistuese.

Në fund, ne duhet të jemi mjaftueshëm të përrulur që të pranojmë të vërtetën kurdoherë që ne e gjejmë atë dhe nga kushdo që e shqipton atë, qoftë kur ajo vjen nga një studiues që na kundërvihet, një shkencëtar me mendime të papajtueshme me tonat, apo një njeri i zakonshëm. Ibn Rexhepi ka përcjellur: “Një pjesë e paraardhësve të drejtë kanë thënë: Përrulësia është që ti ta pranosh të vërtetën nga cilido që e sjellë atë, madje edhe në qoftë se ai është në moshë të njomë. Cilido që e pranon të vërtetën nga cilido që e sjellë atë, qoftë ai i ri apo i thyer në moshë, pavarësisht nëse ti e do apo jo atë, atëherë ai është i përrulur. Cilido që refuzon të pranojë të vërtetën për shkak se ai e sheh atë që e sjellë si poshtë vetes, atëherë ai ka një krenari arrogante.”^[25]

Këto prirje në qëndrim janë parakushte jo vetëm për të përftuarit e kompetencës në informacion, por në mënyrë të ngjashme edhe për të arritur sukses në të nxënien fetare dhe në të mësuarit e të diturisë që ka të bëjë me këtë botë. Më tutje ne do të diskutojmë disa prej parimeve metodologjike që gjejnë zbatim specifikisht për situatën tonë sot.

Autoriteti i informacionit

Kompetenca në informacion varet nga aftësia për të dalluar një burim të besueshëm nga një burim më pak ose aspak të besueshëm. Ne lipset që të jemi të aftë të identifikojmë ekspertët në fusha të ndryshme, përfshirë organizmat dhe shoqatat e tyre kryesore. Sigurisht, ekspertiza nuk është e pagabueshme. Studiuesit individualë dhe madje edhe organizata të tëra bëjnë gabime, por ekspertët kanë më tepër të ngjarë që të jenë korrektë se sa njerëzit e thjeshtë. Kjo u jep atyre një masë të caktuar autoriteti në fushat e tyre, për shkak se ata kanë përgjegjësi publike për gabimet e tyre. Ata janë burimet e para prej nga kërkohet dituria. Të mbështeturit mbi ekspertët në këtë mënyrë është koncepti që njihet me emrin *autoriteti i informacionit*.

Allahu na thotë që të pyesim ekspertët sa herë që ne nuk dimë diçka, sikundërse ka thënë Ai: “Në qoftë se nuk dini, atëherë pyesni ata që e njohin Librat e Shenjtë.”^[26] Ky urdhër i është drejtuar jobesimtarëve, të cilët dyshonin se kumti i Islamit nuk pajtohej me shpalljet e mëparshme. Dijetarët e hershëm myslimanë e interpretuan frazën “populli i librit” se ajo tregon dijetarët çifutë dhe të krishterë, të cilët do të konfirmonin vërtetësinë e shpalljes së Pejgamberit (a.s.), ose mund të ketë edhe kuptimin e dijetarëve të Kuranit.^[27] Nga ky ajet mund të nxjerrim një parim të përgjithshëm se mënyra për të përfutur dije është që pyetjet t’i drejtohen një udhëzuesi ekspert. Kjo është e vetmja mënyrë për të kapërcyer injorancën rreth një çështje të caktuar, sikundërse ka thënë Pejgamberi (a.s.): “A nuk është bërja e pyetjeve melhemi i padituri?”^[28]

Megjithatë, ne herë herë e gjejmë veten përballë informacioneve nga burime të pabesueshme, informacione këto që mund të jenë ose mund të mos jenë të vërteta. Një incident i tillë ka ndodhur në kohën e Pejgamberi (a.s.) dhe Allahu shpalli udhëzim për situata të tilla. Allahu ka thënë: “O ju besimtarë, nëse një ngatërrestar ju sjellë lajme, kontrollojini ato më parë, që të mos u bëni padrejtësi të tjerëve padashje dhe që më vonë të mos pendoheni për atë që keni kryer.”^[29] Në hadithe të ndryshme thuhet se ky ajet është shpallur për Uelid ibn ‘Ukbeh. Pejgamberi (a.s.) e dërgoi atë që të mblydte zekatin nga fiset e Benu Mustalik, të cilët kishin përçafuar Islamin së fundmi. Uelidi kishte frikë prej tyre, ndoshta për shkak të një mosmarrëveshjeje që ai kishte aptur me ata apo për shkak të një thashethemi që kishte dëgjuar (kjo në varësi të transmetimit), kështu që ai u kthye tek Pejgamberi (a.s.) dhe pretendoi pa pasur të drejtë se fiset kishin refuzuar që të jepnin zekatin dhe se ata kishin dashur ta vrisnin. Pejgamberi (a.s.) nuk e priti aspak mirë këtë lajm dhe dërgoi Halid Ibn Uelidin që të hetonte çështjen. Halidi zbuloi se në të vërtetë ata ishin ende myslimanë dhe se fjalët për kryengritjen e tyre kishin qenë të rreme. Mbas kësaj ngjarje, Pejgamberi (a.s.) tha: “Gjakftohësia është prej Allahut, dhe ngutja është prej Shejtanit,”^[30] dhe më pas erdhi ajeti që cekëm më sipër.^[31] Bejhakui e ka përcjellur këtë hadith, krahas ajetit, në lidhje me të përmbajturit nga dalja e nxituar në konkluzione, në nënkaptullin mbi “sjelljet e kadilerëve” në kuadrin e kapitullit mbi “verifikimin në gjykim”.

Ky ajet dhe shkak i zbritjes së tij na japin një mësim të rëndësishëm: kur shohim se jemi të ekspozuar ndaj informacioneve të dyshimta, lipset kujdes. Këndimi standard i këtij ajeti u thotë besimtarëve që të “kërkojnë qartësim” (*tebejjenu*), por një këndim tjetër autentik thotë gjithashtu “kërkoni verifikim” (*tethebbetu*).^[32] Këto dy kuptime përforcojnë njëri tjetrin. Një grup dijetarësh e ka zgjeruar ndalesën në fjalë duke përfshirë edhe përcjelljen e ngjarjeve nga njerëz të cilët janë me “status të panjohur” (*mehxhul el-hal*), si për t’i paraprirë mundësisë që ata të jenë pa besueshmëri.^[33] Historikisht, kadilerët myslimanë e zbatonin këtë parim që në hapat e parë të një procesi gjyqësor, teksa vlerësonin besueshmërinë (*te’dil*) e një dëshmitari në gjykatë nëpërmjet një procesi vetingu (*tezkijeh*).^[34]

Kur ne aksesojmë informacion me rëndësi nga një burim jo i besueshëm, ne kemi përgjegjësinë që të

hetojmë më tutje përpara se se të veprojmë mbi atë informacion ose përpara se ta mohojmë atë. Ambiguiteti është i pashmangshëm në mjedisin e sotëm të informacionit, kështu që duhet të jemi në gjendje që të verifikojmë pretendimet e dyshimta, ose, nëse verifikimi nuk është i mundur, të mos pezullohet gjykimi mbi të. Në këtë kontekst, skepticizmi i shëndetshëm, por jo cinizmi që e merr si të mirëqenë më të keqen e mundshme, është një qëndrim i rëndësishëm që do mbrujtur.

Prandaj, ne duhet të tregohemi të kujdesshëm kundër përhapjes së keqinformimit në formën e emaileve zinxhir, mesazheve *spam*, teorive të konspiracionit, dhe artikujve me lajme të rreme, pasi të gjitha këto qarkullojnë me bollëk në mjedisin online dhe dëmtojnë shoqërinë. Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Ka rënë në pavërtetësi ai që shqipton me gjuhë gjithçka që dëgjon.”^[35] Pra, mjafton si gjynah për një njeri që të jetë i mallkuar në Amëshim nëse ai shpërfilltazi përcjell thashetheme, fjalë, dhe informacione të paverifikuara tek të tjerët. Ky rrezik është edhe më real në kohën tonë, pasi gënjeshtria mund të transmetohet në mbarë botën me shpejtësinë e dritës, dhe kjo literalisht.

Si kundërpeshë ndaj keqinformimit kemi, ndër të tjera, edhe referimin tek ekspertët dhe autoritetet të cilët mund të *kontrollojnë me fakte* pretendimet e ndryshme. Librat akademikë i nënshtrohen recensimit nga autorë të tjerë, përpara dhe pas publikimit, kështu që studiuesit që nuk pajtohen me njëri tjetrin mund të vënë në dukje gabimet dhe mospajtimet që ata kanë. Nevojitet zotësi e kompetencës akademike, një vetëdije e burimeve të kolegëve që kanë shkruajtur mbi temën, dhe të metodave në mënyrë që të shoshiten narrativat konkurruese në kampuset universitare. Organizma të tëra kanë degë që i dedikohen vetëm zbërthimit të pretendimeve të rreme që ngrihen në lëmitë e tyre gjegjëse. Pavarësisht se për cilën fushë bëhet fjalë, kompetenca në informacion mbështetet mbi identifikimin e burimeve të besueshme për të verifikuar pohimet kontraverse.

Kredibiliteti është gjithashtu një funksion i anasjelltë i njëanshmërisë; sa më e madhe njëanshmëria, aq më pak i besueshëm burimi. Studiuesit, organizatat, dhe entitete të tjera pashmangshmërisht mbajnë një *qëndrim* të caktuar karshi lëndës me të cilën ata punojnë, ndoshta kjo është më e dukshme në mjedisin aktual mediatik. Organet mediatike kanë pa dallim një prirje politike apo kombëtare, qoftë kur bëhet fjalë për qëndrime të krahut të djathtë apo të majtë, pro-qeveritare apo në favor të opozitës. Asnjë burim mediatik nuk është i çliruar nga tendenca për të anuar në njërën mënyrë apo tjetrën (sikundër kjo qëndron për të gjithë njerëzit, të cilët pashmangshmërisht përdorin si burim përvojat e tyre subjektive jetësore). Rrjedhimisht, një aspekt i *kompetencës mediatike* është aftësia për të vlerësuar artikujt e lajmeve sipas burimeve të tyre, metodave të tyre dhe standardeve editoriale të tyre. Ofruesit e një informacioni mund të kenë konflikte interesi që kanë të bëjë me atë informacion, një njëanshmëri kjo që duhet ta marrim në konsideratë kur shqyrtojmë pretendimet e tyre.

Për të parë se si funksionon kjo në mjedisin online, që ka të ngjarë të jetë vendi i parë ku shumë prej nesh lipset që të zbatojnë këto parime, Amber Benham na jep disa udhëzime për të vlerësuar faqet në internet:

Pyesni veten: Kush e ka shkruar këtë artikull? Kush e sponsorizon faqen? A ka përmbajtja në fjalë ndonjë axhendë? A është e plotë, e përpiktë dhe aktuale? Ç’lloj faqeje është kjo? A është URL e përshtatshme për llojin e përmbajtjes që gjendet në faqe?

Interneti është një mjet i fuqishëm që ofron një sasi të jashtëzakonshme informacioni, por verifikimi, verifikimi, verifikimi mbetet ende thelbi i gjithçkaje. Kur merr në konsideratë gjithçka që ke hetuar, besojë instikteve për të vlerësuar nëse mund t’i besosh informacionit që ke gjetur. Mos i prit drurët shkurt, dhe mos harro: Ti blerës, bëj kujdes – edhe kur nuk bëhet fjalë për para që kalojnë nga njëri

Ka shumë batakçinj, mashtrues, dhe hajdutë në rrjet të cilët janë aty për të të shitur ty premtime të rreme dhe mallra pa vlerë. Ka artistë profesionistë të lajmeve të rreme të cilët duan që të ndikojnë në opinionin tuaj për të përfituar prej jush duke përdorur dezinformimin e targetuar. Dhe ka islamofobë profesionistë të cilët janë të specializuar në demonizimin e Islamit, njerëzve të tij, dhe traditave të tij. Duke u familjarizuar me parimet e kompetencës në informacion, ju mund të mbron veten nga të gjithë këta predatorë të botës *online*, si edhe nga dhënia e kontributit tuaj për aktet e tyre zullumqare.

E fundit, ndonëse autoriteti është një parim kyç në kompetencën në informacion, ai ka gjithashtu edhe caqet e veta. Autoriteti është *kontekstual* dhe *i ndërtuar* nga komunitetet. Ekspertiza në një lëmi nuk transferohet pa vështirësi në një lëmi tjetër. Një ekspert biologjie nuk është domosdoshmërisht ekspert teologjie, dhe anasjelltas. Edhe autoriteti gjithashtu mund të jetë i pamërituar dhe i mveshur gabimisht. Të mbështetesh krejtësisht mbi autoritetin, e njohur në jurisprudencën islame kjo si *taklid*, ndonjëherë është e lejueshme dhe e domosdoshme kur ne nuk e kemi aftësinë për të hetuar më tej. E prapëseprapë, të vepruarit në këtë mënyrë nënkupton se ti po bën një *argumentum ad verecundiam*, një argument të bazuar vetëm e vetëm mbi autoritetin, gjë që është potencialisht një gabim logjik për shkak se, siç e dimë, autoriteti nuk është i pagabueshëm. Për rrjedhojë, për të ecur përtej mbështetjes mbi autoritetin, ne lipset që të mësojmë se si të studiojmë një temë apo një fushë dhe më pas të bëhemi vetë autoritete.

Rrënjët dhe degët

Çdo fushë që mund të studiohet ka në vetvete një hierarki të përparësive; fillimisht konceptet dhe parimet, më pas problematikat dytësore, dhe në fund çështjet tretësore. Për të zotëruar një temë apo një fushë, duhet të mësohen dhe të përthithen bazat e saj përpara se të ecet më tutje në hollësitë e saj.

Në këtë mënyrë, dijetarët i kanë ndarë lëmitë islame të dijes në parime themelore apo “rrënjë” (*el-usul*) dhe nga këto nxirren problematikat e nënrenditura apo “degët” (*el-furu*). Sipas Imam Xhujnit (rahmet pastë), “‘Rrënja’ është ajo mbi të cilën bazohen temat dytësore. Dega është ajo që bazohet mbi një temë parësore.”[37] Njëlloj si pema, pjesët më të rëndësishme janë rrënjët, të cilat e mbajnë pemën të ngulitur fort dhe bëjnë të mundur që ajo të rritet. Degët janë po aq të rëndësishme, por ato gjithnjë – *gjithnjë* – dalin mbasi rrënjët zënë vend.

Kjo metodë e të mësuarit ilustron më së miri nga shqyrtimi i kurrikulës bazë në jurisprudencën islame, apo fik’h. Për shembull, në qoftë se unë dëshiroj të bëhem ekspert në medhshubin shafiit, unë do të duhej që t’i filloja studimet e mia me një tekst themelor, siç *Metn Ebi Shuxha*, që tregon pozicionin apo verdiktin e shkollës në fjalë për çdo mesele pa diskutuar evidencat apo mospajtimet në gjirin e kësaj shkolle. Mbasi të kem kuptuar mjaftueshëm këtë tekst bazik, unë do të duhej të kaloja te komentaret dhe hollësitë e mëtejshme në lidhje me problematikat brenda vetë medhshubit shafiit. Kur të kem përfunduar studimin e duhur të këtyre teksteve, unë do të duhej të kaloja te vepra më të gjëra, më gjithëpërfshirëse dhe më krahasimtare, siç është *el-Mexhmu’ Sherh el-Muhedhdheb* të Imam Neveviut, ku krahasohen pikëpamjet e medhshubit shafiit me ato të medhshibeve të tjera. Përgjatë këtyre studimeve të mia, unë do të isha në gjendje që të përftoja një ekspertizë në medhshubin shafiit dhe në

fik'hun në përgjithësi. Mirëpo, mbërritja te "fondi" i një kursi studimi dhe përftimi i ekspertizës nuk është kurrësi fundi i të mësuarit rreth një teme të veçantë; ka gjithnjë shumëçka tjetër për të mësuar.

Nëpërmjet të nxëniet të strukturuar, hierarkik dhe të bazuar në kurrikula sipas kësaj mënyre, duke u fokusuar mbi parimet themelore përpara hollësive, studentët mund të arrijnë të zotërojnë mjeshtërisht temat e tyre. E njëjta dinamikë është në veprim në lëmi të ndryshme të diturisë. Çdo disiplinë ka *vepra referenciale*, siç janë enciklopeditë, të cilat japin përmbledhtazi gjendjen aktuale të njohurive në çdo fushë të dhënë. Këto fusha kanë tekste bazike, që zakonisht quhen 'hyrje', të cilat u paraqesin studentëve 'tablonë e gjerë' të fushës në fjalë. Mbas këtyre hyrjeve vijon vepra më të specializuara e më të imtësishme që eksplorojnë një çështje të veçantë të dorës së dytë në të gjitha hollësitë e saj.

Burimet akademike konsistojnë kolektivisht në vepra referenciale, monografi (libra nga një autor i vetëm), vëllime të edituara, konspekte librash, artikujt revistash shkencore, fjalorë tematikë, dhe zhanre të tjera. Çdo kategori literature luan një rol specifik në përfitim e dijes, dhe ato luajnë role të ndryshme në fusha të ndryshme. Kësisoj, të bëhesh i lexuar në një fushë të caktuar do të thotë të jesh i ditur rreth literaturës së saj të specializuar. Një student duhet të ketë një panoramë të përgjithshme të literaturës dhe të fillojë të studiojë në një trajektore që kalon nga tekstet fillestare, më pas tek të ndërmjetmet, dhe në fund tek të avancuarat, nën udhëzimin e një eksperti. Krahas kësaj, çdo disiplinë ka terminologjinë e saj të specializuar, ajo çka dijetarët myslimanë të periudhës klasike e kanë quajtur *mustalahat*. Për shembull, në medhhebin hanefi, gjen terma si "imami më i madh", dhe "dy shehlerët", dhe "Shehu i Islamit", dhe "tre imamët tanë", e kështu me radhë.^[38] Një lexues nuk mund ta kuptojë se për çfarë bëhet fjalë nëse nuk konsultohet me një ekspert apo një fjalor specifik për temën në fjalë. Në mënyrë të ngjashme, çdo fushë ka 'gjuhën' e saj që duhet mësuar në mënyrë që ta kuptosh siç duhet dhe të kesh përparim në të.

Nxënia nuk duhet të jetë vetëm e strukturuar dhe metodike, por studentët gjithashtu lipset të kenë aftësitë kërkimore teknike për të zbuluar dhe aksesuar burimet e reja. Puna kërkimore moderne po kryhet gjithnjë e më tepër *online* duke përdorur sisteme kompjuterike dhe mjete zbulimi siç janë motorët kërkimorë dhe agregatorët e përmbajtjes. Librat, artikujt dhe të dhënat aksesohen nga databazat kërkimore duke përdorur *fjalë kyçe* dhe *leksik të kontrolluar* (edhe një tjetër arsye e fortë për të njohur 'gjuhën' e fushës). Kërkimet mund të filtrohen dhe rafinohen për të gjetur burime edhe më relevante. Çdo databazë dhe çdo mjet kërkimor, si Google Scholar, ka avantazhet, disavantazhet, dhe kleçkat e veta, kështu që çdo hulumtues duhet të mësojë se si të nxjerrë maksimumin nga secili mjet kërkimor që përdor.

Për më tepër, burimet që ne gjejmë zakonisht citojnë burime të tjera. Duke shqyrtuar bibliografitë dhe faqet me titull "veprat e konsultuara", një praktikë kjo që duhet "*nxjerrje nga dheu*" i *citimeve*, ne mund të zgjerohemi duke gjetur burime të mëtejshme; një artikull çon në një libër, që nga ana e tij shpie në një autor ekspert, i cili çon në një shkollë mendimi në këtë fushë, e cila më pas shpie drejt një shoqate akademike. Çdo vepër e re studimore përthith veprën e autorëve të mëparshëm, duke i lejuar kështu një hulumtuesi që të gjurmtojë me efikasitet zanafillat e koncepteve.

Në fund, krijimi i dijes shpesh është një *bashkëbisedim* i papërfunduar ndërmjet ekspertëve. Të dëgjosh perspektiva të shumta dhe të pranosh diversitetin e opinionëve redukton njëanshmërinë dhe korrigjon gabimet. Në botën akademike, ky është procesi *peer review*, konspektimi nga hulumtues të tjerë. Një studiues apo ekspert i vetëm nuk mund të përfaqësojë perspektivën e vetme, apo pjesën më të madhe të perspektivave, mbi një problematikë të caktuar. Për shembull, në veprën autoritative mbi

fik'hun e avancuar hanefi, *el-Hidaje fi Sherh Bidaje el-Mubtedi* nga Imam Merginani[39] autori rrëfen për disa raste kur vetë dishepujt e Imam Ebu Hanifes nuk pajtoheshin me të, apo kur medhhebi hanefi nuk pajtohet me Shafiun, dhe kështu me radhë, ndërkohë që aty jepen argumente, evidenca, dhe arsyetime për qëndrimin e parapëlqyer nga autori. Dijetarë të tjerë iu kundërpërgjigjën këtyre argumenteve me argumentet, evidencat dhe arsyetimet e tyre, dhe e gjitha kjo tregon për një dialog të pandërprerë midis ekspertëve.

Sot, dija islame nuk është thjesht në duart e disa pak dijetarëve individualë. Tamam tamam, ajo gjallon në bashkësi të gjera, shoqata, dhe këshilla, pikërisht sikundër medhhebi hanefi nuk përfaqëson thjesht dhe vetëm pikëpamjet e Ebu Hanifes (rahmet pastë), por korpusin kolektiv dhe kumulativ të mijëra dijetarëve përgjatë shekujve të cilët ndoqën metodologjinë e tij. Ngjashëm, organizmat kryesore shkencore, ditunore, dhe profesionale pasqyrojnë përpjekjet e kombinuara të ekspertëve të shumtë individualë.

Një njeri duhet të synojë që të avancojë në fushën e tij apo të saj në mënyrë që të bëhet një *kontribues* ekspert në tregun e informacioneve, dhe jo vetëm një *konsumator*. Një ekspert në lulëzim e sipër e bashkangjit veten në një bashkësi ditunore apo një organizatë të tillë, ku shkëmbehen ide dhe informacione, dhe ku mund të ofrohet mbikëqyrje dhe udhëzim për ata që sapo e kanë filluar rrugëtimin e tyre në kërkimin e dijes. Këto organizma veprojnë si furnizues dhe verifikues të informacionit, dhe, nëpërmjet këtij funksioni, ato lehtësojnë krijimin e dijes së re dobiprurëse për breznitë e ardhshme. Siç ka thënë fizikani i madh Sir Isak Njutoni: “Në qoftë se kam arritur të shohë më larg, kjo ka ndodhur sepse jam ngritur mbi supet e gjigantëve.”[40]

Konkluzion

Kompetenca në informacion është seti i aftësive moderne që nevojiten për të zbuluar, aksesuar, verifikuar, dhe për të interpretuar me saktësi informacionin në një epokë të keqinformimit të skajshëm në internet. Kjo është ndoshta kompetenca kyçe e shekullit të 21, thelbësore për prosperimin e civilizimit njerëzor – në po të njëjtën mënyrë sikundër shkrim-këndimi ka qenë për breznitë e mëparshme – si edhe për shëndetin fetar të bashkësisë myslimane. Ajo bazohet mbi tendencat qëndrimore, apo tiparet e karakterit, gjë që përkon me mësimet myslimane mbi kërkimin e dijes dobiprurëse për jetën, verifikimin e të vërtetës, dhe përlësinë intelektuale. Ajo përmban gjithashtu parimet metodologjike të të vlerësuarit të burimeve, të konsultuarit me ekspertët dhe komunitetet e ekspertëve, të nxënimit kurrikular, strategjitë kërkimore, “nxjerrja nga dheu” e citimeve, si dhe zotësitë teknike kompjuterike.

Duke përfutur dhe duke i mësuar këto aftësi në gjirin e bashkësisë tonë, ne mund të mbrojmë vetet tona, familjet tona, dhe bashkësitë tona nga dezinformimi islamofobik, nga artistët batakçinj, nga lajmet e rreme, nga teoritë e konspiracionit, dhe nga burime të tjera të ngjashme të mashtrimit. Ç’është më e rëndësishmja, ne kështu do të mbrojmë shpirtat tanë nga gjynahu i bashkëfajësisë në propagandimin mbarëbotëror të narrativave të rreme, mashtrimit, dhe gënjeshtreve.

Suksesi vjen nga Allahu, dhe Allahu e di më së miri

Justin Parrot ka një bakaloriat në Fizikë dhe Anglistikë nga Universiteti Otterbein, një MLIS nga Universiteti Kent State, një Mres në Studime Islame nga Universiteti i Uellsit, dhe aktualisht është Bibliotekar Hulumtues për Studimet e Lindjes së Mesme në Universitetin e New York në Abu Dabi.

Burimi: <https://yaqeeninstitute.org/justin-parrott/finding-truth-in-the-age-of-fake-news-information-literacy-in-islam/>

Përktheu: Arjol Guni

[1] Oxford Living Dictionaries, “post-truth.” <https://en.oxforddictionaries.com/definition/post-truth>

[2] Ibn al-ʿajjaj al-Qushayrī Muslim, *ʿaʿʿʿ Muslim* ([Bayrūt]: Dʿr Iʿyʿʿ al-Kutub al-ʿArabʿyah, 1955), 1:14, *al-muqaddimah, bab fi an al-isnad min al-din*.

[3] American Library Association (ALA), “Framework for Information Literacy for Higher Education.” <http://www.ala.org/acrl/standards/ilframework>

[4] Alan Bundy, *Information Literacy: The Key Competency for the 21st Century* (Adelaide: University of South Australia Library, 1998), 1.

[5] John Naisbitt, *Megatrends: Ten New Directions Transforming Our Lives* (New York: Warner 1982), 24.

[6] Imʿm al-ʿaramayn al-Juwaynʿ and Jalʿl al-Dʿn Muʿammad ibn Aʿmad al-Maʿallʿ, *Sharʿ al-Waraqʿt fʿ Uʿʿʿl al-Fiqh* (Filasʿʿn: Jʿmiʿat al-Quds, 1999), 79-80.

[7] Sureja Zumner 39:9.

[8] Anne P. Mintz, Amber Benham, et al., *Web of Deceit: Misinformation and Manipulation in the Age of Social Media* (Chicago: Information Today, Inc, 2012), ix-x.

[9] Alan Bundy. *Information Literacy: The Key Competency for the 21st Century* (Adelaide: University of South Australia Library, 1998), 17.

[10] Sureja Taha 20:114.

[11] Muʿammad ibn Yazʿd ibn Mʿjah, *Sunan Ibn Mʿjah* (Bayrūt: Dʿr Iʿyʿʿ al-Turʿth al-ʿArabʿ, 1975), 1:81 #224, *kitab al-muqaddimah, bab fadl al-ʿulamaʿ*; deklaruar sahih nga Albani në komentari.

[12] Ismʿʿʿl ibn ʿUmar ibn Kathʿr, *Tafsʿr al-Qurʿn al-ʿAzʿm* (Bayrūt: Dʿr al-Kutub al-ʿIlmʿyah, 1998), 5:281, ajeti 10:114.

[13] Sulaymān ibn Aḥmad al-ʿabarī, *al-Muʿjam al-Kabīr*. (al-Qāhirah, al-Riyāḥ: Maktabat Ibn Taymīyah, Dār al-ʿumayyī, 1983), 10:180 #10388; deklaruar sahih nga Albani në *Saḥīḥ al-Jāmiʿ al-Saḡḡir* ([Dimashq]:al-Maktab al-Islāmī, 1969), 2:1125 #6624.

[14] Muʿammad ibn ʿibbān, *ʿaḥḥ Ibn ʿibbān* (Bayrūt: Muʿassasat al-Risālah, 1993), 14:100 #6217, *kitab al-tarikh, bab dhikr al-suʿal kalim Allah jall wa ʿala*; Albani e ka quajtur hadithin hasen ne komentar.

[15] Yūsuf ibn ʿAbd Allāh ibn ʿAbd al-Barr, *Jāmiʿ Bayʿn al-ʿIlm wa Faʿlih* (al-Dammām: Dār Ibn al-Jawzī, 1994), 1:401 #579.

[16] Ibid., 1:406, #586.

[17] Aḥmad ibn Marwān al-Dīnawarī. *al-Mujʿlasah wa Jawʿhir wal-ʿIlm* (al-Baʿrayn: Jamʿiyat al-Tarbiyah al-Islāmīyah, 1998), 2:186, #308.

[18] Ibn ʿAbd al-Barr, *Jāmiʿ Bayʿn al-ʿIlm wa Faʿlih*, 1:408, #591.

[19] Muslim, *Saḥīḥ Muslim*, 4:1836 #2363, *kitab al-fadaʿil, bab wujub imtithal ma qalahu sharʿan dun ma dhakarahu*.

[20] Ibid., 4:1835 #2362.

[21] Ibn Abī ʿatīm, *ʿadab al-Shāfiʿ wa Manʿiqibuh* (Bayrūt: Dār al-Kutub al-ʿIlmīyah, 2002) 1:244.

[22] Ibn Mʿjah, *Sunan Ibn Mʿjah*, 2:1263 #3843, *kitab al-duaʿ, bab ma taʿawudh minhu*; hasen nga Albani.

[23] Abū ʿatīm al-Ghazzālī, *Iʿyāʾ ʿUlūm al-Dīn* (Bayrūt: Dār al-Maʿrifah, 1980), 1:30.

[24] Ibn ʿajar al-Haytamī. *al-Fatḥ al-Kubrā al-Fiqhīyah* (Bayrūt: Dār al-Kutub al-ʿIlmīyah, 1997), 4:313.

[25] Abd al-Raḥmān ibn Aḥmad ibn Rajab, *Jāmiʿ al-ʿUlūm wal-ʿikam* (Bayrūt: Muʿassasat al-Risālah, 2001), 1:307, #13.

[26] Sʿrat al-Anbiyāʾ 21:7; Abdel Haleem, *The Qurʿan*, 323.

[27] Al-Taʿbarī, *Jāmiʿ al-Bayʿn ʿan Taʿwīl al-Qurʿān* (Bayrūt: Muʿassasat al-Risālah, 2000), 18:413-414, ajeti 21:7.

[28] Abū Dʿwād Sulaymān ibn al-Ashʿath al-Sijistānī, *Sunan Abū Dʿwād* (ʿaydī, Lubnān: al-Maktabah al-ʿArabīyah, 1980), 1:93, #337, *kitab al-taharah, bab fi al-majruh al-tayammum*; hasen nga Albani.

[29] Sʿrat al-Hʿujurʿt 49:6; Abdel Haleem, *The Qurʿan*, 517.

[30] Aḥmad ibn al-ʿusayn al-Bayhaqī, *al-Sunan al-Kubrā* (Bayrūt: Dār al-Kutub al-ʿIlmīyah, 2003), 10:178 #20270, *kitab adab al-qadi, bab al-tathabut fi al-hukm*; sahih nga Al-Haythamī në *Majmaʿ al-Zawʿid wa Manbaʿ al-Fawʿid*

(al-Q?hirah: Maktabat al-Quds?, 1933), 8:19 #12652.

[31] Mu?ammad ibn A?mad al-Qur?ub?, *J?mi? li-A? k?m al-Qur?an* (al-Q?hirah: D?r al-Kut?b al-Mi?r?yah, 1964), 16:311-312, ajeti 49:6.

[32] al-Ta? bar?, *J?mi? al-Bay?n 'an Ta'w?l al-Qur'?n*, 22:286, ajeti 49:6.

[33] Ibn Kath?r, *Tafs?r al-Qur?n al-'Az??m*, 7:345, ajeti 49:6.

[34] Ron Shaham, *The Expert Witness in Islamic Courts: Medicine and Crafts in the Service of Law* (Chicago: University of Chicago Press, 2010), 37.

[35] Muslim, *Sa? h??h ?Muslim*, 1:11, #5, *al-muqaddimah, bab al-nahi 'an al-hadith bi-kuli ma samia'*.

[36] Anne P. Mintz, Amber Benham, et al., *Web of Deceit*, 161.

[37] al-Juwayn? and al-Ma?all?, *Shar? al-Waraq?t f? U? ?l al-Fiqh*, 66.

[38] Maryam Mu?ammad ??li? al-?ufayr?, *Mu?? ala? ?t al-Madh?hib al-Fiqh?yah wa Asr?r al-Fiqh al-Marm?z f? al-A? l?m wal-Kutub wal-?r?? wal-Tarjî? ?t* (Bayr?t: D?r Ibn ?azm, 2002), 1:92.

[39] Vëllimi i pare i këtij libri të mirënjohur është botuar nga Erasmus me titull “Manual i fikhut hanefi” dhe pajisur me shënime nga Rezart Beka sh.p.

[40] Alexandre Koyré, “An Unpublished Letter of Robert Hooke to Isaac Newton.” *Isis* 43, no. 4 (1952): 315. <http://www.jstor.org/stable/227384>

Date Created

21/08/2020

Author

justin-parrot